



RREZIQET KRYESORE NGA KORRUPSIONI NË PROKURIMET PUBLIKE NË NIVEL LOKAL DHE REKOMANDIME PËR TEJKALIMIN E TYRE



Kingdom of the Netherlands



Center for Civil Communications
Центар за граѓански комуникации

Botim elektronik: Rreziqet kryesore nga korrupsioni në prokurimet publike në nivel lokal dhe rekomandime për tejkalimin e tyre

Botues:

Qendra për Komunikime Qytetare

Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe

Agon Ismaili

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

352:[343.352:35.073.53(497.7)

КЛУЧНИ ризици од корупција во јавните набавки на локално ниво и препораки за нивно намалување [Електронски извор] / преведено од македонски на англиски јазик од Магдалена Симионска ; преведено од македонски на албански јазик од Агон Исмаили. - Текст во пдф формат, содржи 36 стр., илустр. - Скопје : Центар за граѓански комуникаци, 2023

Начин на пристапување (URL): <https://www.ccc.org.mk/>. - Напореден текст на алб. и англ. јазик. - Наслов преземен од екран. - Опис на изворот на ден 17.02.2023 год.

ISBN 978-608-4974-17-8

а) Локална самоуправа -- Јавни набавки -- Корупција -- Спречување -- Македонија

COBISS.MK-ID 59412229

Dokumenti për politikat publike është përpiluar në kuadër të projektit “Mbrojtje nga korrupsioni” me asistencë financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup, ndërsa i zbatuar nga Qendra për Komunikime Qytetare, në periudhën nga 1 nëntor 2021 deri më 31 nëntor 2024.

PËRMBAJTJA

HYRJE

04

RREZIQET KRYESORE NGA KORRUPSIONI

06

REKOMANDIME PËR TEJKALIMIN E RREZIQEVE NGA KORRUPSIONI
NË PROKURIMET PUBLIKET

07

HYRJE

Rreziqet kryesore nga korrupsioni në vetëqeverisjet lokale dhe në ndërmarrjet publike të nivelit lokal janë identifikuar nëpërmjet monitorimit të prokurimeve publike të këtyre institucioneve, monitorim i cili bazohet mbi metodologji të unifikuar nga ana e 8 organizatave joqeveritare në këto 8 komuna të vendit: Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Negotinë, Strumicë, Tetovë, Çair dhe Shtip. Monitorimi mbi prokurimet publike është zbatuar nga Qendra Kulturore Rinore-Manastir, Koalicioni rural - Kërçovë, Qendra për dialog ndërkulturor Kumanovë, Shoqëria ekologjike VillaZora Veles, Shoqata për hulumtime dhe analiza, NOVUS Strumicë, Shoqata Multikultura Tetovë, Shoqata e qytetarëve ZIP INSTITUT për politika dhe qeverisje të mirë Shkup, Shoqata EHO – organizatë edukuese humanitare Shtip nën udhëheqje të Qendrës për Komunikime Qytetare.

Mundësia për të paraqitur pasqyrë objektive dhe të matshme të rreziqeve nga korrupsioni ishte bazë e mirë për përpilim të rekomandimeve dhe synimeve të qarta, drejt realizimit të të cilave duhet të orvaten institucionet e monitoruara me qëllim që ta reduktojnë korrupsionin dhe keqpërdorimin e mjeteve publike.

Përzgjedhja e indikatorëve në bazë të cilëve është bërë mapimi i korrupsionit në prokurimet publike në komunat, është bërë duke i marrë parasysh:

- indikatorët e njohur ndërkombëtarisht për vlerësim të korrupsionit në prokurimet publike;
- indikatorët, të cilët gjatë monitorimit shumëvjeçar mbi prokurimet publike në nivel nacional dhe në nivel lokal të vendit nga Qendra për Komunikime Qytetare janë vlerësuar si relevantë në detektimin e korrupsionit në prokurimet publike;
- indikatorët mbi të cilët bazohet i ashtuquajtimi sistem i flamujve të kuq, i zhvilluar nga Byroja prokurime publike e të cilët përdoren për përpilim të raporteve dhe analizave nga ana e Byrosë dhe dorëzohen në Entin Shtetëror për Revizion dhe në Komisionin Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit me qëllim të përpunimit të tyre të mundshëm dhe/ose për të ndërmarrë aktivitete shtesë; dhe
- detyrimet për parandalim të korrupsionit në prokurimet publike, të cilat rezultojnë nga Strategjia nacionale për luftë kundër korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021-2025.

Raportet e ndara, me rreziqet kryesore nga korrupsioni për secilën vetëqeverisje lokale dhe ndërmarrjet publike të nivelit lokal tani më janë publikuar dhe mund t'i gjeni edhe në [ueb faqen](#) e Qendrës për Komunikime Qytetare <https://www.ccc.org.mk/>. Së këtëjmi, qëllimi i këtij dokumenti për politikat publike është që në një vend të përmbledhen rreziqet kryesore nga korrupsioni dhe rekomandimet që jepen për tejkalimin e tyre.

Dokumenti për politikat publike përgatitet në kuadër të projektit “Mbrojtje nga korrupsioni” dhe ka për qëllim zvogëlim të korrupsionit dhe të keqpërdorimit të mjeteve publike në nivel të vetëqeverisjes lokale nëpërmjet rritjes së transparencës, përgjegjësisë dhe integritetit të institucioneve lokale si dhe nëpërmjet implementimit të masave të parapara në Strategjinë nacionale për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave 2021-2025.

RREZIQET KRYESORE NGA KORRUPSIONI

Shkalla e ulët e realizimit të planeve vjetore për prokurimet publike është detektuar edhe në vetëqeverisjet lokale edhe në ndërmarrjet publike. Gjatë kësaj, realizimi mesatar i planeve për prokurimet publike në vetëqeverisjet lokale është 68% e planifikimit vjetor, ndërsa te ndërmarrjet publike, kjo përqindje është më e ulët dhe arrin vetëm 55%.

Procesi i planifikimit të prokurimeve publike në vetëqeverisjet lokale dhe në ndërmarrjet publike të nivelit lokal është analizuar përmes këtyre katër parametrave: (1) miratimi i planeve për prokurime publike dhe publikimi i tyre në Sistemin Elektronik për Prokurimet Publike (SEPP) brenda afatit ligjor deri më 31 janar në vitin rrjedhës; (2) publikimi i planeve për prokurime publike në ueb-faqen e secilit institucion; (3) numri dhe përqindja e ndryshimeve të planeve për prokurime publike dhe (4) përqindja e realizimit të planeve.

Monitorimi i prokurimeve publike të zbatuara në tetë vetëqeverisjet lokale dhe në 21 ndërmarrje publike të nivelit lokal e të cilat i kanë themeluar komunat, rezultoi me të dhënat që ato me kohë i miratojnë planet për prokurime publike dhe në mënyrë konsekuente i përmbahen detyrës për publikimin e planeve në SEPP, gjë që nuk mund të thuhet për publikimin e planeve dhe të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e njëpasnjëshme në ueb-faqen e institucioneve.

Sa u përket ndryshimeve dhe plotësimeve të planeve për prokurime publike, është vërejtur që në vitin 2021 ato kanë qenë të shpeshta dhe të konsiderueshme. Gjatë kësaj, vetëqeverisjet lokale mesatarisht kanë ndryshuar madje 38% të përmbajtjes së planeve për prokurime publike me ç'rast përqindjet e paraqitura veçmas janë nga 13% e deri 66%. Te ndërmarrjet publike, mesatarja e ndryshimeve të planeve është 10%, ndërsa përqindjet e paraqitura veçmas lëvizin nga 0% deri 33%. Ndryshimet e shpeshta të planeve, sipas Byrosë për Prokurime Publike mund të çojnë deri në zvogëlim të besimit të komunitetit të biznesit dhe të publikut si dhe mund të jenë tregues për elemente korrupsioni dhe subjektivizmi për ndonjë prokurim i cili nuk ka qenë paraprakisht i planifikuar.

Ndërkaq, mesatarja e nivelit të realizimit të planeve për prokurime publike në vetëqeverisjet lokale është 68% dhe lëviz nga 45% deri 87%, ndërsa te ndërmarrjet publike, mesatarja e nivelit është vetëm 55% dhe lëviz nga 25% deri 100%. Përqindja e ulët e realizimit të planeve vjetore për prokurime publike mund të jetë indikator për menaxhim të dobët të nevojave dhe parashikim të dobët të mjeteve të duhura dhe si rrjedhojë, paraqet rrethanë të frytshme për elemente potenciale korruptive në përzgjedhjen e prokurimeve të planifikuara të cilat do të realizohen, e cilat prokurime nuk do të realizohen.

Zbatimi i tenderëve është i shoqëruar me konkurrencë të pamjaftueshme, me dominim të firmave konkrete që i fitojnë tenderët dhe me anulime të shpeshta të tenderëve.

Procesi i zbatimit të procedurave për prokurime publike është analizuar përmes nëntë parametrave edhe atë: (1) numri mesatar i ofertuesve në tenderët; (2) sa janë të shpeshtë tenderët me një ofertë; (3) vështrim nëse dominon vetëm një ofertues ose numër i vogël i ofertuesve; (4) shkalla e aplikimit të ankandit elektronik në procedurat; (5) sa shpesh anulohen tenderët; (6) zbatimi i procedurës me negociata pa shpallje paraprake të konkursit; (7) shpallje të konkurseve për prokurimet publike dhe të dokumentacionit të tenderit në ueb faqen e institucioneve; (8) numri i ankesave të parashtruara nga operatorët ekonomikë dhe (9) përqindja e ankesave të pranuar nga Komisioni Shtetëror për Ankesa për Prokurimet Publike (KShAPP).

Te komunat, numri mesatar i ofertuesve në tenderët është 3.6 ofertues në një tender që është mesatare relativisht solide dhe mbi mesataren shtetërore e cila në vitin 2021, sipas të dhënave nga Byroja për Prokurime Publike ka qenë 3.3 ofertues në një tender. Përkundër kësaj, te ndërmarrjet publike, numri mesatar i ofertave në një tender është vetëm 2.5, që është konsiderueshëm nën mesataren nacionale. Numri mesatar i ofertave është një nga parametrat më relevantë për vlerësim të asaj nëse procedurat zbatohen në mënyrë konkurrencte dhe se gjatë procedurës nuk ka pasur kufizime mbi konkurrencën.

Për të pasur pasqyrë më të plotë sa i përket elementit të konkurrencës, shumë është me rëndësi që parametri i parë (numri mesatar i ofertave në një tender) të plotësohet edhe me përlogaritjet për parametrin e dytë, pra sa janë të shpeshtë tenderët për të cilët është dhënë vetëm një ofertë. Analizat e bëra tregojnë që në tetë vetëqeverisjet lokale të monitoruara, mesatarisht në 24% të tenderëve është dorëzuar vetëm nga një ofertë. Te ndërmarrjet publike, kjo përqindje është pak më e lartë dhe arrin deri 26%. Mund të konstatohet që edhe në vetëqeverisjet lokale edhe në ndërmarrjet publike, ky indikator sugjeron në rrezik të zmadhuar nga korrupsioni i mundësuar nëpërmjet kufizimeve mbi konkurrencën.

Dominimi i vetëm një ofertuesi apo i një numri të vogël të ofertuesve në tenderët e një komune ose ndërmarrjeje publike padyshim mund të interpretohet si manifestim i favorizimit të dukshëm të ofertuesve konkretë. Tek të gjitha tetë vetëqeverisjet lokale është konstatuar pjesëmarrje e lartë e vlerës së marrëveshjeve për prokurime publike të nënshkruara me një firmë, në vlerën e përgjithshme të prokurimeve të vetëqeverisjes lokale dhe ajo ka qenë nga 18% deri 36%. Te ndërmarrjet publike, pjesëmarrja e një firme në vlerën e përgjithshme të prokurimeve është nga 11% deri në madje edhe 100% në rast të një ndërmarrjeje publike, ku në një procedure për prokurim publik janë nënshkruar dy kontrata me të njëjtën firmë. Përgjithësisht, mund të vlerësohet që ky parametër sugjeron në ekzistim të rreziqeve të zmadhuara nga korrupsioni nëpërmjet favorizimit të firmave konkrete edhe në vetëqeverisjet lokale edhe në ndërmarrjet publike.

Aplikimi i shpeshtë i ankandit elektronik (e-ankand) në kushte kur nuk ka konkurrencë, çon drejt rrezikut të zmadhuar që kontratat për prokurime publike në pjesë të madhe të jenë nënshkruar me çmime të cilat janë më të larta nga çmimet reale të tregut. Shfrytëzimi intensiv i ankandit elektronik ka ngelur nga versioni i mëparshëm i Ligjit për prokurime publike, thellë i rrënjosur te nëpunësit e angazhuar për prokurime publike. Përkatësisht, në vitin 2021, në vetëqeverisjet lokale, e-ankandi mesatarisht ka qenë i planifikuar në 85% të tenderëve, ndërsa është zbatuar në vetëm 54%, kurse te ndërmarrjet publike, ky dallim është edhe më i madh dhe ankandi elektronik ka qenë i planifikuar për 94% të tenderëve, ndërsa është zbatuar në vetëm 51%. Rreziku nga korrupsioni paraqitet edhe nga aty që e-ankandi ua mundëson ofertuesve të merren vesh për çmimin dhe ndarjen e biznesit, para mbajtjes së ankandit.

Te këto tetë vetëqeverisjet lokale të përfshira në monitorim është konstatuar që kanë numër të ankesave të pranuar nga firmat i cili është më i lartë se mesatarja shtetërore (4,4%), ndërsa te ndërmarrjet publike, numri i ankesave është shumë më i ulët. Në vetëqeverisjet lokale, përqindjet e paraqitura veçmas në raport me numrin e përgjithshëm të tenderëve në nivel vjetor lëvizin nga 1,6% deri në 15%.

Transparenca lidhur me publikimin e shpalljeve për prokurime publike dhe të dokumentacionit në ueb faqen e institucioneve ende nuk është në nivelin e dëshiruar. Ky problem është veçanërisht i theksuar në ndërmarrjet publike, ku thajse gjysma prej tyre nuk kanë as ueb faqe.

Problemi me anulimet është në veçanti i theksuar në disa vetëqeverisje lokale dhe ndërmarrje publike. Monitorimi i tenderëve që janë zbatuar në vitin 2021 sugjeron që mesatarisht, komunat kanë anuluar 26% të tenderëve. Përqindja e procedurave të anuluar në komuna të caktuara arrin edhe deri në përqindjen prej 37%. Nga aspekti i këtij parametri, gjendjet në ndërmarrjet publike janë edhe më problematike me atë që në 6 nga gjithsej 21 ndërmarrje publike, përqindja e procedurave të anuluar është mbi 30%.

Sa i përket zbatimit të procedurës me negociim pa shpallje të konkursit, gjendja është më e mirë. Procedurë të këtillë kanë zbatuar vetëm 3 nga tetë vetëqeverisjet lokale edhe atë në shuma deri 1% të vlerës së përgjithshme të prokurimeve të tyre. Edhe në ndërmarrjet publike, këtë procedurë e kanë zbatuar vetëm 3 nga 21 ndërmarrjet e analizuara, në vlera nga 0,1% deri 24%.

Llogaridhënie e pamjaftueshme për realizimin e kontratave për prokurimet publike.

Vetëqeverisjet lokale thonë që përcaktojnë një ose më tepër persona të cilët janë të angazhuar për të monitoruar realizimin e kontratave për prokurimet publike. Kjo praktikë e mirë nuk është inkorporuar në shtatë prej ndërmarrjeve publike të monitoruara.

Të gjitha vetëqeverisjet lokale të monitoruara e respektojnë detyrimin ligjor për dorëzim të njoftimeve për kontratat të lidhura në SEPP. Por, megjithatë, tek të gjitha komunat në përqindje të ndryshme është vërejtur vonesë në përmbushjen e kësaj detyre si dhe tejkalim i afatit ligjor prej 10 ditësh për njoftim pas nënshkrimit të kontratës. Ndërkaq, sa u përket ndërmarrjeve publike, është detektuar që katër prej tyre, asnjëherë nuk kanë dorëzuar me kohë njoftim për kontratë të lidhur.

Institucionet e monitoruara nuk e respektojnë në mënyrë konsekuente detyrimin ligjor për dorëzim të njoftimeve për marrëveshje të realizuar dhe kanë vonesë të konsiderueshme në publikimin e tyre në SEPP.

Përveç në SEPP, institucionet duhet t'i publikojnë njoftimet për kontratat e lidhura dhe njoftimet për marrëveshjet e realizuara edhe në ueb faqen e tyre. Publikimi i të gjitha dokumenteve relevante për prokurimet publike në SEPP nuk mund të konsiderohet si përmbushje e detyrës për përgjegjësi ndaj qytetarëve. Për t'u përdorur SEPP si burim informacionesh, nevojitet informim i konsiderueshëm që më së shpeshti mungon te qytetarët. Së këtejmi, institucionet janë të detyruara të gjitha informacionet relevante t'i publikojnë në ueb faqen e tyre. Dobësitë në njoftimin e qytetarëve me prokurimet publike nëpërmjet ueb faqeve të vetë institucioneve janë në veçanti problematike te ndërmarrjet publike. Nga monitorimi, ka rezultuar që vetëm tre nga të gjitha 21 ndërmarrje publike i shpallin njoftimet për marrëveshjet e lidhura për prokurime publike bashkë me tekstet e marrëveshjeve si dhe njoftimet për marrëveshjet e realizuara.

REKOMANDIME PËR TEJKALIMIN E RREZIQEVE NGA KORRUPSIONI NË PROKURIMET PUBLIKE

- » Vetëqeverisjet lokale dhe ndërmarrjet publike të përpunojnë dhe të zbatojnë akt intern (libër procedural apo udhëzues) për zbatimin e prokurimeve publike e në të cilin do të përcaktohet mënyra e veprimit të nëpunësve të angazhuar dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm në të gjitha fazat e procesit të prokurimeve publike në të cilat janë të përfshirë, si dhe do të përcaktohet mënyra e veprimit në rastet e denoncimit të korrupsionit në prokurimet publike. Në këtë mënyrë, do të sigurohet monitorim më i lehtë i procesit të prokurimeve publike dhe do të mundësohet nivel më i lartë i njohjes së procedurave dhe rregullave nga të gjithë ata që janë të përfshirë në prokurimet publike, që është posaçërisht e rëndësishme për të punësuarit të cilët nuk janë të fushës së prokurimeve publike, ndërsa të cilët janë anëtarë në komisionet për prokurime publike. Përpilimi i rregullave të brendshme do të mundësojë që në mënyrë të qartë të përkufizohen detyrat e të gjithë atyre që janë të përfshirë në procedurat për prokurime publike, edhe atë nga planifikimi i prokurimeve publike, nëpërmjet zbatimit të procedurave e deri në realizimin e plotë të kontratave. Inkorporimi i politikës interne për prokurime publike është detyrimi cili buron edhe nga sistemi për integritet dhe inkorporimi i këtij sistemi është realizuar me iniciativë të Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit.
- » Të respektohet obligimi ligjor i cili përcakton që secili organ kontraktues të ketë një person të certifikuar për prokurime publike dhe të punohet në drejtim të ndërtimit të vazhdueshëm të kapaciteteve të kuadrove që janë të përfshirë në procesin e zbatimit të prokurimeve publike.
- » Të përmirësohet procesi i planifikimit të prokurimeve publike. Ndryshimet e shpeshta në planin për prokurimet publike dhe mungesa e sistemit për monitorim të realizimit të tij shpijnë në planifikim të dobët të prokurimeve publike dhe menaxhim joefikas me mjetet publike.
- » Të kushtohet vëmendje në dokumentacionin e tenderëve dhe specifikacionet teknike që të mos kufizohet konkurrenca, por të nxitet ajo, me qëllim që të ketë numër më të madh ofertash. Në fakt, vetëm konkurrenca më e madhe është garanci që do të fitohet vlera më e mirë për paratë e shpenzuara në prokurimet publike.
- » Të intensifikohet mënyra transparente e komunikimit ndërmjet organit kontraktues dhe operatorëve ekonomikë si dhe asociacioneve të tyre, veçanërisht nëpërmjet ushtrimit të dialogut më të shpeshtë teknik dhe organizimit të takimeve për sqarime. Komunitat dhe ndërmarrjet publike duhet më shpesh ta praktikojnë dialogun teknik, i cili me Ligjin për prokurime publike paraqet mënyrë opsionale për konsultim të operatorëve ekonomikë. Kjo formë komunikimi ndërmjet organit kontraktues dhe ofertuesve potencial duhet të praktikohet gjatë përgatitjes së prokurimeve, pavarësisht vlerën e tyre. Dialogu teknik është veçanërisht i

domosdoshëm në prokurime për të cilat, organi kontraktues nuk është i njoftuar me gjendjen në treg dhe me pjesëmarrësit në të, ose lënda e të cilit prokurim, duhet të prokurohet është e ndërlikuar, përkatësisht për përshkrimin e së cilës, organi kontraktues nuk ka ekspertizë të mjaftueshme.

- » Është e nevojshme të aplikohet parimi i rotacionit të punonjësve si anëtarë të komisioneve për prokurime publike edhe në vetëqeverisjet lokale edhe në ndërmarrjet publike. Ky rekomandim rezulton nga ajo që disa vetëqeverisje lokale dhe ndërmarrje publike e kanë të njëjtin komision për prokurime publike për të gjitha procedurat që i zbatojnë. Me zbatimin e këtij propozimi do të shmangen ose do të zvogëlohen mundësitë për arritje të marrëveshjes së palejuar ndërmjet ofertuesve dhe anëtarëve të komisioneve për prokurime publike – rrezik, i cili ekziston në qoftë se anëtarë në komisionet janë gjithmonë personat e njëjtë. Njëkohësisht, do të përkufizohen kompetencat duke pamundësuar akumulimin e kompetencave në të njëjtin vend pune ose tek i njëjti punonjës.
- » Ankandi elektronik të aplikohet vetëm për produkte me cilësi të njohur dhe të standardizuar dhe për të cilat ka konkurrencë në treg. Po ashtu, këmbëngulja e vazhdueshme për ankand elektronik duhet të jetë sinjal për organet udhëheqëse në institucion për rrezik të zmadhuar për keqpërdorime në procesin e prokurimeve publike dhe për stimulim të arritjes së marrëveshjeve ndërmjet firmave.
- » Duhet të zbatohen analiza dhe vlerësime të brendshme periodike dhe konsistente për rezultatet nga prokurimet publike të zbatuara, të cilat do t'i përfshijnë të gjitha segmentet dhe fazat në procesin e prokurimeve publike, duke filluar nga planifikimi i prokurimeve e deri në realizimin e plotë të kontratave, duke i përfshirë edhe kontrollet e kryera të jashtme. Segment i veçantë të cilit duhet t'i kushtohet vëmendje është konkurrenca në procedurat për prokurime publike. Analiza duhet të tregojë për cilat lëndë të prokurimeve ka konkurrencë (3 ose më tepër oferta të dorëzuara) dhe për cila lëndë nuk ka konkurrencë (nuk ka asnjë ofertues ose janë më së shumti dy ofertues). Në këtë kontekst, duhet të analizohen shkaqet për konkurrencën e dobët dhe në çfarë shkalle, mungesa ose numri i vogël i ofertave për ndonjë lëndë prokurimi përkon me mesataren nacionale për lëndën konkrete të prokurimit.
- » Të mos aplikohet lehtë dhe shpesh anulimi i procedurës në baza konkrete, ndërsa kur të bëhet kjo, të jepen arsyetime të hollësishme për t'u vërtetuar nëse anulimi është i bazuar. Me reduktimin ose me pamundësimin e anulimit të procedurave në raste kur nuk mund të përzgjidhet ofertuesi i favorizuar, zvogëlohet edhe korrupsioni në prokurimet publike. Në anën tjetër, arsyetimet e detajuara gjatë shfrytëzimit të bazave konkrete për anulim të procedurës do të kontribuojnë për rritje të transparencës dhe përgjegjësisë së organit kontraktues.

- » Në mënyrë konsekuente të përmbushen detyrimet nga Ligji për prokurime publike për shpalljen e njoftimit për kontratë të lidhur në afat prej 10 ditësh nga nënshkrimi i kontratës dhe detyrimet për njoftimin për kontratë të realizuar në afat prej 10 ditësh nga realizimi i plotë i kontratës. Duke i respektuar këto detyrime ligjore, nga njëra anë, organet e përfshira kontraktuese do të dëshmojnë se punojnë në pajtim me ligjin, kurse në anën tjetër, do të kontribuohet për rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë në procesin e prokurimeve publike, ndërsa me atë do të rritet edhe besimi i qytetarëve dhe i shfrytëzuesve të shërbimeve të komunës dhe të ndërmarrjeve publike në nivel lokal.
- » Në ueb faqet të publikohen të gjitha informacionet relevante për prokurimet publike. Për ndërmarrjet publike, të cilat ende nuk kanë ueb faqe të hartuar, detyrimin për shpalljen e informacioneve relevante duhet ta kenë vetëqeverisjet lokale si themelues të tyre. Krahas asaj që të gjitha informacionet për prokurimet publike shpallen në SEPP, ueb faqet e organeve kontraktuese janë pasqyrë e transparencës së tyre dhe prandaj në një pikë të këtillë të cilën e viziton publiku më i gjerë duhet të jenë në dispozicion edhe këto informacione edhe atë në mënyrë që do të jenë lehtë të kuptueshme për të gjithë qytetarët. Paraqitja e rëndomtë e linqeve të cilat drejtojnë në Sistemin Elektronik për Prokurime Publike nuk është modeli i dëshiruar i transparencës dhe llogaridhënies. Duhet të jepen sqarime të mira lidhur me përmbajtjen e atyre linqeve dhe çfarë qytetarët mund të gjejnë në ato.
- » Për çdo kontratë të nënshkruar për prokurim publik duhet të përcaktohet një ose më tepër persona për monitorim të realizimit të kontratave me qëllim që të mbahet evidencë e përpiktë e përmbushjes së detyrimeve nga kontrata siç është afati i livrimit, sasia dhe cilësia përkatëse në pajtim me dokumentacionin e tenderit dhe kontratat, si dhe të mbahet evidencë e përpiktë financiare e pagesave të bëra lidhur me prokurimet dhe ngjashëm.

